



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

PROCESVERBAL

**Takime tematike për Udhërrëfyesin (Road Map)
me anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

Tiranë, 25, 26 dhe 27 prill 2018

Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në bashkëpunim me Ekspertizën Teknike organizuan një raund paraprak takimesh për të informuar dhe konsultuar me anëtarët e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) lidhur me dokumentin e rishikuar të Udhërrëfyesit (Road Map).

Këto tre takime u organizuan në ambjentet e Kryeministrit, sipas drejtimeve strategjike të përcaktuara në dokument dhe morën pjesë përfaqësues nga KKShC si edhe përfaqësues të strukturave/institucioneve shtetërore.

TAKIMI I PARË

Datë: 25 prill 2018, Ora 10:00, Kryeministri

Drejtimi strategjik 1:

Bashkëpunim i institucionalizuar i qeverisë me shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe integrimin në BE.

Të pranishëm:

1. Znj. Afërdita Seiti
2. Z. Altin Hazizaj
3. Z. Vladimir Thanu

Në mënyrë të përmbledhur u parashtruan dhe u diskutuan:

- Nevoja e rishikimit të Udhërrëfyesit ka ardhur si nevojë e riorganizimit të përgjegjësive
- Dokumenti “ Strategic Direction” do të publikohet nga AMSHC
- Nga analiza që është bërë nuk ka patur monitorim, të paktën duhet një herë në vit të ketë një input për Udhërrëfyesin
- Të ndërtohet një organizëm i brendshëm që të përditësohen të dhënat e monitoruara, ku të kenë akses Ministritë dhe ku bëhen raportimet nga grupet ndërminstrore. Ky raport më pas t’i kalojë KKSHC-së
- Përsa i përket pikës “Ensure implementation according to annual work plan” u diskutua se duhet bërë pjesë aktive dhe shoqëria civile jo vetëm për implementim por edhe në planifikim
- Ministritë bëjnë plane 3 mujore të cilat janë në zbatim të planeve 5 vjeçare
- Një nga pyetjet e shtruara nga anëtarët e shoqërisë civile ishte: Përse nuk publikohen planet e punës vjetore të Ministrive?

Çështja e planit të punës mund të diskutohet në mbledhjet e mëdha të KKSHC-së, dhe të kërkohet nga përfaqësuesit e qeverisë që të paraqesin në Këshill Planin e punës.

- Në dokumentin “Strategic Direction” të futet edhe Roli i Kryetarit të KKSHC-së, që ka për detyrë të drejtojë Këshillin
- AMSHC do të fuqizojë rolin e saj, mund të ketë një person që do të ndjekë punën me Udhërrëfyesin në Ministri
- Pika nr. 4 në dokumentin e sipërpërmendur: Cilat janë praktika të mira dhe cilat quhen të tilla?

Është herët të themi si do të jetë procesi dhe cilit proces do t’i ngjajë (ekspertiza nga vendet fqinje na solli shembuj të ndryshëm).

Ekspertizën qeveria e merr nga shoqëria civile, procesi që po ndjek qeveria është ai i dialogut hap pas hapi.

- Ky dokument duhet të vlerësohet nga ana financiare, për të vlerësuar kostot dhe më pas do të miratohet. Duhet të ndahet gjithashtu me Delegacionin e BE në mënyrë që të diskutohet për një Join-financial plan.

Znj. Christine i përgjigjet se kostot janë bërë nga Eksperti financiar. Ajo shpjegon se pjesa e financimit nuk është pjesë e ekspertizës.

TAKIMI I DYTË

Datë: 26 prill 2018, Ora 10:00, Kryeministri

Drejtimi strategjik 2:

Një mjedis ligjor mundësues dhe qeverisja e të dhënave/informacionit

Të pranishëm:

1. Z. Blendi Dibra
2. Z. Ergys Gezka
3. Z. Luan Ahmetaj
4. Z. Vladimir Thanó

Në mënyrë të përmbledhur u parashtruan dhe u diskutuan:

- Përfshihen 2 prioritete:
 1. Krijimi i një kuadri legjislativ për regjistrimin e shoqatave në mënyrë sa më të lehtësuar, të bëhet nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)
 2. Të krijohet një regjistër elektronik
- Ka shumë organizata në gjendje pasive, duhet shfuqizuar ligji i vjetër dhe duhen krijuar grupe pune
- Ka plan veprimi për çdo gjë, mund të diskutohet edhe në mbledhjet e mëdha të KKSHC-së, por nuk mund të pretendohet që të gjitha këto të bëhen brenda vitit 2018.
- Nga ana tjetër AMSHC do të monitorojë procesin. Po përgatitet një pyetësor të detajuar për shoqatat për të kuptuar sa aktive janë, sa punonjës kanë etj.

Në këtë vetëdeklarim të shoqatave duhet të jemi të ndërgjegjshëm se nuk do të japin numrin real të vullnetarëve.

Për këtë prioritet janë analizuar 4 skenarë. Skenarët janë analizuar si në aspektin administrativ ashtu edhe teknik, të cilët kanë si gjëra pozitive dhe negative.

Nëqoftëse bëhet ndryshim në ligj do të duhet të bëhet ndryshim dhe në ligjet e tjera të lidhura me të, si psh ligji për QKB-në.

- Ideja është të krijohen dy sisteme:
 1. Regjistri online ndërtohet me të njëjtat parametra të regjistrimit të biznesit.
 2. Ky sistem ndërvepron automatikisht me regjistrin e taksave.

Në nivel Teknologjie të Informacionit ky regjistër është më i lehtë se të tjerët për t'u realizuar.

- AMSHC të dhënat do t'i krijojë duke i marrë nga Regjistri Kombëtar, të cilat do të transferohen periodikisht. AMSHC ka për detyrë të mbledhë disa të dhëna nga shoqatat që nuk do t'i marrë Qendra Kombëtare e Biznesit.

- Në momentin e regjistrimit kush do të kontrollojë te dhenat?

Ka disa kritere të vendosura nga QKB-ja (ashtu siç është edhe për bizneset), gjithashtu dokumentat e paraqitura do të noterizohen.

- Është bërë takim edhe me QKB-në, të cilët kanë konfirmuar se aktualisht kanë kapacitetet e duhura për të regjistruar biznëset, gjithashtu disponojnë ekspert ligjor që bën kontrollet e duhura.
- Përsa i përket planit buxhetor, është analizuar edhe pjesa buxhetore, ka plan për çdo analizë
- Anëtarësia e këtij dokumenti është e Krymenistrisë, është kërkesë e saj prandaj jemi këtu.
- Në momentin që do të bëhen ndryshimet në ligj sigurisht që do të ketë grupe pune, të cilët do të kenë përfaqësuesit e tyre
- Çdo hap është i ndërlidhur me njëri - tjetrin. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga ana tjetër po merret me ligjin për shërbimet sociale.

TAKIMI I TRETË

Datë: 27 prill 2018, Ora 10:00, Kryeministri

Drejtimi strategjik 3:

Mundësimi i kuadrit fiskal dhe financimit

Të pranishëm:

1. Z. Ali Coka
2. Z. Blendi Dibra
3. Znj. Iris Luarasi

Në mënyrë të përmbledhur u parashtruan dhe u diskutuan:

- Prioriteti 8 ka të bëjë me krijimin e një kuadri ligjor në përputhje me praktikën e BE
- Për rishikimin e legjislacionit ekzistues duhen bërë ndërhyrje që i qëndrojnë kohës
- Është kërkuar që Udhërrëfyesi të kthehet në një matricë ku të parashikohen çfarë mund të financojë qeveria dhe çfarë mund të financojnë donatorë të tjerë
- Afati kohor 2020 parashikon të gjitha hapat e procesit
- Në funksion të ligjit të KSHC-së, a mund të krijohet një qender kombëtare financimi të OJF-ve me fondet Publike?

Eksperti ligjor: Në Shqipëri mund të merren fonde nga kontraktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë. Ne rekomandojmë Shqipërinë të bëjë zgjedhje të vlefshme, legjislacioni aktual ka nene që mund t'i atashohen organeve shtetërore. Përmes buxhetit shtetëror OJF-të duhet të përmirsojnë cilësinë e punës por jo sasinë. Përshtetull duke angazhuar organizatat e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve për qytetarin nëpërmjet financimit nga buxheti i shtetit i cili duhet të vijë gjithmonë në rritje në të ardhmen. Praktika më në mira në Shqipëri për sa u tha më sipër janë: AMSHC, Bashkia e Tiranës etj.

Krijimi i mekanizmit financiar është i rëndësishëm por duhet të ecet me hapa të vegjël. Ngritja e një qendre nuk është prioritet në këtë moment.

- Viti 2020 duket një afat kohor i largët (duke qenë se përkon dhe me vitin e zgjedhjeve). Ta afrojmë të paktën 2019.
- Nga analizat që kanë bërë ekspertët është e pamundur si nga ana financiare dhe administrative ta afrosh datën e realizimit të procesit

- Z. Blendi shprehet se një mangësi e procesit është konsultimi me KKSHC-në . Duhet të përfshihemi më shumë në konsultim në të gjitha fazat e procesit. Gjithashtu duhet të krijojmë elemente që të vihen përpara përgjegjësisë institucionet publike.
- Znj. Merita shprehet se na ka ardhur një letër nga Zv. Kryeministrja që të bëjmë një raport për konsultimin me shoqërinë civile, në një kohë që në vend se të merremi me Udhërrëfyesin meqë kemi akoma ekspertet këtu, duhet të bëjmë raportime. Ne jemi të detyruar me rregullore të raportojmë çdo akt ligjor, gjithashtu dokumentat strategjike i nënshtrohen një konsultimi me grupet e interesit. Nuk ka një institucion publik që nuk i nënshtrohet kësaj procedure. Duhet bërë një klasifikim i OJF-ve, të identifikohen ato të cilat kanë më shumë kapacitete dhe kanë më shumë vite në treg për të ndihmuar qeverinë. Nuk duhen trajtuar të gjitha OJF-të njësoj.
- Nëqoftëse një here ose dy herë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore nuk paraqiten në mbledhjet e KKSHC-së, herën e tretë Kryetarja do ta raportojë
- Çfarë është propozuar në Udhërrëfyes është në sinergji me njëra – tjetrën. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është çelësi në këtë proces, sepse operon mbi dy ligje shumë të rëndësishme si ligji për “Mbrojtjen sociale” dhe ligji për “Ndërrmarjet sociale”.
- Për prioritetin 9 të Udhërrëfyesit janë parashikuar katër masa për mënyrat e raportimit financiar. Duhet të bëhet analiza nga ana financiare: cilat janë efektet financiare makro dhe mikro? Duhet të bëhet kjo analizë pa e dëmtuar sistemin financiar.
- Znj. Christine pyet: “Kjo çështje është dhe në Udhërrëfyesin e vjetër dhe është akoma një pikë e rekomandimeve themelore. Por cili do të merret me këtë?”
Znj. Valbona përgjigjet: “Është ngritur një njësi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që po merret me këtë çështje dhe mund të them se deri vitin tjetër mund ta kemi ndryshuar. Duhet të vlerësojmë fisibilitetin.
- Znj. Iris pyet: “Si mund të paguajë taksat një organizatë që ka vështirësi financiare?
Eksperti përgjigjet: “Nëqoftëse qeveria pranon që organizata të mos taksohen, atëherë te zëri i buxhetit duhet të dalë 0 (zero).”
- Përsëri vazhdoi diskutimi për afatet e implementimit të prioritetit 9, i cili është maksimumi viti 2020. Ky afat (*deadline*) është detyrues.
- Masa nr 2: të njësohen akset ligjore ekzistuese dhe të përgatitet një manual Auditit për taksat.

Ekspeti: Këto dy veprime erdhën nga konsultimet me shoqërinë civile. Ekziton besimi se legjislacioni është i harmonizuar me atë të BE-së. Problemi nuk është ligji, por impelmentimi i tij.

Problemi është se organizatat operojnë me projekte afatshkurtra jo në vazhdimësi.

Si mund të planifikojnë Bashkitë rimbursimin e TVSH-së (VAT)?

Zyra e taksave nuk punon fare me ligjin. Prandaj është e justifikuar në dokumentin tonë që disa ligje duhet të rishikohen.

- Znj. Valbona prezanton në Powerpoint Masën nr 9.4
- Përderisa dokumenti nuk është finalizuar ende, komentet dhe propozimet duhet të dërgohen brenda javës që vjen, në mënyrë që të reflektohen brenda kohës së prezencës së ekspertëve të jashtëm.
- Znj. Merita: Duhet të shprehet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë çështje.

Eksperti shprehet se kostot do t'i dergojnë të martën.

- Znj. Christine: Financimi i shoqërisë civile nga qeveria është 10% e asaj që paguajnë donatorët e tjerë. Kjo duhet të ndryshojë, duhet të ketë më shumë fonde nga qeveria për shoqërinë civile.